



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2020:063757

Datë: 29.02.2024

Numri i dokumentit: 05396945

C. nr. 785/2020

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË GLLOGOC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil**, me gjyqtarin Astrit Gashi dhe sekretaren juridike Fatmire Mehmeti, në çështjen juridike kontestimore të paditëses **N.T** nga Gllogoci, të cilën e përfaqëson i autorizuari i saj sipas autorizimit I.D nga Gllogoci, kundër të **paditurës Komuna e Gllogocit, Drejtoria për Arsim**, rruga “Fehmi e Xhevë Lladrovci”, me objekt kontesti **Kompensim i shujtës ditore** me vlerë të kontestit prej **2,260.00 €**, jashtë seancës gjyqësore me datën 29.02.2024 e mori këtë:

**A K T G J Y K I M**  
**PA SHQYRTIM KRYESOR TË ÇËSHTJES**

- I. APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses N.T nga Gllogoci, mësimdhënëse në shkollën fillore SHFMU “R...” në Gllogoc.
- II. DETYROHET** i padituri Komuna e Gllogocit, Drejtoria për Arsim në Gllogoc që paditëses ti kompensoj në emër të **shujtave ditore** për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri me datën 21.11.2022 për gjithsejt 1130 ditë aktive pune shumë e përgjithshme prej **2260 €**, me kamatë ligjore prej 8% në vit duke filluar nga data 05.06.2020 kur është paraqitur padia e deri në pagesën përfundimtare, si dhe të ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 135 €, të gjitha këto në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi e nën kërcënimin e përmbarimit ligjor.
- III. REFUZOHET si e pabazuar** kërkesa e paditësit që të detyrohet i padituri të ia paguaj shpenzimet procedurale mbi shumë e aprovuar nga pika II të këtij dispozitivi.

**A r s y e t i m**

Paditësi, me datën 05.06.2020, ka paraqitur padi të cilën padi e ka precizuar me parashtresën e datës 14.09.2023, kundër të paditurës për kompensim të shujtës ditore për 1130 ditë të punës, duke theksuar se paditësja ka themeluar marrëdhënie pune në SHFMU ”R...” në Gllogoc, ku punon si mësimdhënëse.

Paditësja ka ushtruar kërkesë në procedurë jashtëgjyqësore për kompensimin e shujtës te e paditura duke u bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit të datës 18.04.2017 por të njëjtit i është refuzuar kërkesa dhe meqenëse e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin në mënyrë vullnetare ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadinë e tij ta aprovtoj si të bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

I padituri me anë të përgjigjes në padi **nuk ka kontestuar se paditësi është në marrëdhënie pune** te e paditura por e ka kontestuar kërkesëpadinë e tij duke theksuar se kërkesëpadia bazohet në kontratën kolektive të vitit 2017 e cila nuk parasheh veprim retroaktiv për realizimin e të drejtës së kërkuar me padi dhe se të njëjtit nuk i takon kompensimi i shujtës sepse **nuk e ka dëshmuar se është anëtar i sindikatës (SBASHK)**. Tutje ka theksuar se kërkesëpadia e paditësit është e **pas afatshme** sepse kontrata kolektive e arsimit e vitit 2017 është lidhur për një afat prej 3 vitesh sipas nenit 90 të Ligjit të Punës, ndërsa lidhur me **kërkesëpadinë për vitin 2021 ka theksuar se punëdhënësi ka afat për sigurimin e këtyre kërkesave deri në vitin 2023**. Ka paraqit edhe pretendimin se: *ushqimi nuk është borgj kryesor pasi që paditësi ka realizuar dhe vazhdon ti realizojë të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës në përputhje me Ligjin e Punës dhe Kontratën e Punës dhe në asnjë rrethanë nuk mund të vlerësohet se ushqimi është borxh kryesor ose dëm i shkaktuar palës paditëse.*

Gjykata ka pasur parasysh përgjigjen në padi të paditurës kur ka theksuar se Kontrata Kolektive ka qenë e vlefshme vetëm deri me datën 18.04.2020 ashtu që kompenzimi për ushqim pas kësaj date nuk ka bazë ligjore, ndërsa për periudhën e kontratës së re kolektive gjer në nëntor 2020 punëdhënësi ka afat për sigurimin e mjeteve për kompenzimin kësaj kategorie të pagave gjer në vitin 2023, por nga të gjitha pretendimet e lartëcekura të të paditurit gjykata vlerëson se edhe pse i padituri **e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditëses, e njëjta nuk i ka mohuar faktet vendimtare** sepse për të **nuk ka qenë** kontestuese se paditësi është mësimdhënëse tek e paditura, përveç që e ka kontestuar afatshmërinë e padisë bazuar në kontratën kolektive të vitit 2017 **nuk e ka kontestuar se të njëjtit i takon e drejta e kompensimit të shujtës ditore në bazë të kontratave kolektive sektoriale** me vet faktin se ka theksuar se *“paditësi nuk duhet kompensuar shujtat për gjer në vitin 2020” dhe “lidhur me kërkesëpadinë për pjesën e mbetur për vitin 2021 ka theksuar se punëdhënësi ka afat për sigurimin e këtyre kërkesave deri në vitin 2023”*.

Sa i përket afatshmërisë së padisë për të cilën gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare është vërtetuar se padia është e afatshme sepse e njëjta është paraqitur me datë 05.06.2020, periudhë kjo gjatë të cilës ka qenë në fuqi kontrata kolektive sektoriale e arsimit e datës 22.01.2021 e cila përfshin edhe periudhën para 05.06.2020 dhe pas, dhe është plotësuar dhe precizuar padia nga paditësi me datën 14.09.2023 për të përfshirë edhe periudhën kohore të kërkesëpadisë për periudhën 2020-2023. Në lidhje me pretendimin e të paditurit se paditësi nuk është anëtar i SBASHK-ut andaj nuk ka të drejtë në shujtë, gjykata vlerëson se nuk është i bazuar sepse nuk është kusht i domosdoshëm për të realizuar të drejtat nga marrëdhënia e punës në sektorin e arsimit. Sa i përket pretendimit se kontrata kolektive nuk ishte në fuqi nga data 18.04.2020 kjo nuk është i bazuar për shkak se Neni 45 i Kontratës Kolektive të vitit 2017 përcakton se: *nga kontrata kolektive palët mund të tërhiqen tre muaj para skadimit të vlefshmërisë së saj përmes letrës rekomanduese e cila tërheqje fillon së zbatuar. Në ditën e nënshkrimit të kontratës së re. Nëse kontrata kolektive pasi të i skadoj afati i përcaktuar nuk tërhiqet asnjëra palë zbatimi i saj vazhdon edhe një vit. Pas skadimit të afatit të kontratës kolektive lidhet kontratë e re. Në fillimin e punës së kontratës së re në gjastëmujorin e parë aplikohen rregullat e kontratës së vjetër”*. Kjo nënkupton se për periudhën prej 18.04.2020 gjer në lidhjen e kontratës së re kolektive me datën 22.01.2021 aplikohet kontrata e vjetër dhe atë edhe 6 muaj pas hyrjes në fuqi të kontratës së re gjer me datën 22.07.2021, dhe në vazhdim gjer në 22 nëntor 2022 aplikohet kontrata e re kolektive. Në lidhje me pretendimin tjetër se *ushqimi nuk është borgj kryesor ose dëm ndaj paditësit ashtu që i njëjti nuk ka të drejtë as në kamatë, kjo nuk është e bazuar për shkak se kompensimi për ushqim janë të drejta nga marrëdhënia e punës dhe rrjedhimisht kërkesë kryesore.*

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi, i ka vlerësuar kushtet ligjore nga Neni 152 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se *“po që se i padituri me anë të*

*përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadiës, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim” lidhur me Nenit 143 dhe 147 të njëjtit ligj, nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij, dhe ka gjetur se në këtë çështje juridike kontestuese plotësohen kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit pa shqyrtim kryesor.*

Gjykata, duke pasur parasysh faktin se e paditura nuk i ka mohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadiës, ka vlerësuar se në këtë çështje juridike kontestuese nuk është e nevojshme mbajtja e shqyrtimit kryesor dhe administrimi i provave për faktet e pohuara.

Andaj, gjykata, konform Nenit 152 të LPK-së gjeti se kërkesëpadija e paditëses është e bazuar dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke iu referuar dispozitave të nenit 35, paragrafi 7 të Kontratave Kolektive të Arsimit në Kosovë nr.2056 të datës 18.04.2017 dhe asaj nr.105 të datës 22.01.2021 në fuqi gjer me datën 22.11.2022 (me dispozita të njëjta në të dy kontratat) – ku përcaktohet se *“Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditës e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”.*

Gjykata me rastin e vendosjes për paditësin lidhur me kompensimin e shujtës është bazuar në vërtetimet e SHFMU “R...” nr... të datës 04.09.2023, sipas të cilave paditësja nga periudha mes viteve 2021/2022 ka pasur 369 ditë aktive të pranisë në punë të cilat kur shumëzohen me 2 € për një shujtë ditore sipas Kontratës Kolektive të Arsimit del që shuma për kompensimin e shujtës për paditësin për këtë periudhë duhet të jetë 738 €, ndërsa në total prej datës 18.04.2017 e gjer me datën 21.11.2022 ka pasur 1130 ditë nga 2 € në ditë në shumën totale 2260 €.

Kamata ligjore është vendosur në kuptim të dispozitave të Nenit 382 të LMD-së, dhe në pajtim edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës për Kamatën e datës 02.12.2022 pika XV dhe arsyetimit të saj, se për dëmin material kamata fillon të rrjedh nga dita e ngritjes së padisë (në rastin konkret e paraqitur me datën 05.06.2020) e deri në pagesën definitive, pavarësisht se kur ka lindur marrëdhënia e detyrimit.

Vendimin nga pika II të dispozitivit që pala e paditur t’i bartë shpenzimet e procedurës gjykata e ka mbështetur në dispozitat ligjore konform Nenit 449 dhe 452 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e këtyre shpenzimeve të aprovuara u referohet, përpilimit të padisë në shumën prej 104 € dhe për taksën gjyqësore për padi në shumën prej 31 €, apo shumën e tërësishme të tyre prej 135 €. Kurse vendimin nga pika III e dispozitivit me të cilën është refuzuar kërkesa e paditësit për shpenzime procedurale (e specifikuar me shkresën-Pasqyra të shpërblimit/shpenzimit të avokatëve e datës 07. 09.2023) mbi shumën e aprovuar nga pika II të këtij dispozitivi, gjykata e ka mbështetur në Nenin 453 par. 1 lidhur me Nenin 463 par. 1 të LPK-së dhe në Tarifën e OAK-së, e njëjta nuk është mjaftueshëm e arsyetuar, dhe nuk janë shpenzime që kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq, ndërsa në bazë të nr. tarifor 6 të Tarifës së OAK-së njihen shpenzimet për parashtresa me të cilat iniciohet procedura e nuk njihen shpenzimet edhe për parashtresat për precizim të kërkesëpadiës siç ka kërkuar paditësi.

Andaj, vlerësuar nga të lartëcekurat duke u bazuar në Nenin të 143 LPK-së gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË GLLOGOC,  
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, C. nr. 785/2020, datë 29.02.2024**

**Gjyqtari**

**Astrit Gashi**

---

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimin të tij pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.